

SHFRYTËZOJNË POZITËN DHE SHPËRBLEJNË VETEN NË LIPJAN

Këshilltarët pronësojnë joligjërisht laptopët si asete publike

Arian Duriqi

LIPJAN, 1 MAJ – Në mbledhjen e fundit të KK të Lipjanit, këshilltarët e kësaj komune asnjëherë nuk kanë qenë më unikë në votimin e tyre se sa në çastin kur e kanë votuar një propozim të tyre. Të gjitha këshilltarët kanë votuar në fakt jashtëligjshëm, duke shndërruar kështu asetet komunale, në këtë rast laptopët, në pronësi personale. Laptopët që i kanë kushtuar Komunës 15 mijë euro dhe që janë blerë me para të tatimpaguesve për secilin këshilltar komunal, tashmë nuk janë pasuri publike, por pronë e këshilltarëve, sepse kështu votuan këta të fundit. Lidhur me këtë çështje, ndërkaq, ka qenë i menjëhershëm edhe një reagim i ashpër nga shoqëria civile e kësaj komune që monitoron Kuvendin. Madje, udhëheqës të Asociacionit Rinor për të Drejtat të Njeriut (YAHR) pos që e shohin këtë veprim të jashtëligjshëm në tërësi, paralamërojnë edhe instancat më të larta për këtë votim. “YAHR reagon ndaj vendimit të KK-së në seancën 26-të të 30 prillit 2012, lidhur me shndërrimin e aseteve komunale, në këtë rast të laptopëve, në pronësi personale të këshilltarëve komunalë”, ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR. Ai ka shtuar se ideja e ekzekutivit komunal të Lipjanit për blerjen e laptopëve ishte e qëlluar, me qëllim të kursimit të shpenzimeve në dërgimin e materialeve të këshilltarët nga ajo e shtypur në atë elektronike, mirëpo që laptopët, sipas tij, ka qenë dashur të ishin vetëm në shfrytëzim dhe jo më tepër. “Në mbledhjen e fundit me iniciativën e këshilltarëve të LDK-së dhe me pëlqim të të gjithë këshilltarëve të tjerë, që marrë vendimi për përvetësim të laptopëve edhe pse ishte jashtëligjshëm, pasi që



Këshilltarët komunalë të Lipjanit votojnë unanimisht për përvetësimin e laptopëve publikë, ndërsa shoqëria civile e gjykon të paligjshëm vendimin

kryesuesi e kishte mbyllur seancën. Këto asete që janë blerë nga tatimpaguesit e Lipjanit nuk është dashur të shndërroheshin në prona personale të këshilltarëve të këtij mandati”, ka thënë Krasniqi. “E konsiderojmë si vendim i jashtëligjshëm dhe i joplotfuqishëm, ndërsa ne do të ankohemi në institucione të tjera relevante”, ka shtuar ai. Ndërkohë që, edhe drejtues të buxhetit në Lipjan po ashtu e kanë parë këtë veprim si jo të drejtë. Petrit Kelmendi, drejtor Buxheti, ka deklaruar se ky ka qenë një veprim jo i matur i këshilltarëve dhe që nuk ka bazë ligjore. “Ata janë pajisur me laptopë për lehtësim punësh, por s’kanë pasur të drejtë t’i përvetësonin, sepse janë pasuri publike”, ka thënë ai. Ndërkohë që, me gjithë përpjekjet ka qenë i pamundur kontakti me Lulzim Rrustemin, kryesues i KK-së, të martën, për të marrë qëndrimin e tij lidhur me këtë votim.

Kryesuesi tërhiqet për

Bajramcurr Hasani

VUSHTRRI, 1 MAJ – “Kam vendosur përfundimisht të tërhiqem nga posti i kryesuesit të KK-së, ku këtë po e bëj publike edhe para jush, dhe nuk do të tërhiqem më nga dorëheqja ime”, ka qenë deklarata e shumëpritur nga opozita e kryesuesit të KK të Vushtrrisë, Ferit Idrizi, në vazhdimin e seancës së 5 prillit, ku spektri opozitar në shenjë pakënaqësie të tërheqjes së dorëheqjes së bërë publike nga kryesuesi pati braktisur seancën, me ç’rast që ndërprerë edhe seanca për mungesë kuorumi. Ndryshe, ish-kryesuesi Idrizi, para një muaji me një shkresë, pati deklaruar se do linte pozitën e kryesimit të KK-së me arsyetimin se është i punësuar edhe në Ministrinë e Arsimit. Ndërkohë, pas një kohe e pas “presioneve politike”, ai deklaroi se kishte vendosur ta tërhiqte dorëheqjen me arsyetimin se kryetari i Komunës kishte kërkuar interpretim ligjor nga MAPL-ja a kishte apo jo konflikt interesi...Ndërsa ky akt i dorëheqjes ka bërë që edhe spektri opozitar, që kohë më parë pati deklaruar se do të dilnin me një kandidat të përbashkët për ta marrë kryesimin e KK-së, të qetësohej, pasi me të nisur seanca shefat e grupeve parlamentare patën mbajtur një takim pesëminutësh, me ç’rast ata patën ndryshuar qëndrimin për mosraktisje seance. “Opozita ditëve në vazhdim do ta bëjë publik qëndrimin rreth kandidatit të opozitës, i cili do të mund ta zërë pozitën e të parit të Kuvendit”, ka qenë përgjigjja e shefit të GP të AAK-së, Qazim Azemi. Ngjashëm pati deklaruar edhe spektri tjetër opozitar, LDK-ja. “Ne si grup parlamentar gjithsesi kemi kandidat ku do të dalim me emër konkret për kryesues të KK-së, pas